

VENDIM
Nr. 206, datë 4.3.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT
RRUGOR “RRËSHEN–KALIMASH”, (KULTURA BUJQËSORE DHE DRUFRUTORË)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Minis-trave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pro-narëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rrëshen - Kalimash” (kultura bujqësore dhe dru-frutorë).
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpro-nësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “kultura bujqësore” dhe “drufrutorë”, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 8 420 000 (tetë milionë e katërqind e njëzet mijë) lekësh, nga të cilat:
 - a) për “kultura bujqësore”, me vlerën 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë;
 - b) për “drufrutorë”, me vlerën 8 402 000 (tetë milionë e katërqind e dy mijë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimi, prej 8 420 000 (tetë milionë e katërqind e njëzet mijë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësimë”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.
 7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Rikonfirmim ZVRPP”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 8. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Rrëshen për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES
 SEKTORI I SHPRONESIMEVE
 AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN SI REZULTAT I
NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR "RRESHEN - KALIMASH" (KULTURAT BUJQESORE DHE DRUFROTORET)

Nr	PRONARI			Z.K	Nr. Pas.	Sip m2 e mbjellë	Kultura bujqësore lekë	Dru frutore lekë	Vlera Totale Leke	SHENIME
	Emri	Atësi	Mbiemri							
1	Mehill	Gjok	Bardhaj	2768	315	200		114000	114000	Rikonfirmim ZVRPP
2	Ndue	Mark	Gega	1190	46	750		294000	294000	Rikonfirmim ZVRPP
3	Gjet	Kol	Marleka	1190	29/4	800		239000	239000	Rikonfirmim ZVRPP
4	Ndrec Lek	Gjok	Marleka Marleka	1190	29/5; 29/6	273		90000	90000	Rikonfirmim ZVRPP
5	Nikoll	Gjon	Prenga	3598	244	300		192000	192000	Rikonfirmim ZVRPP
6	Dod Niko	Nikoll Dode	Pershqefa	1600	2/3; 2/2	500		334000	334000	Rikonfirmim ZVRPP
7	Nikoll	Pjeter	Prenga	3883	68	865		196000	196000	Rikonfirmim ZVRPP
8	Gjet	Preng	Marku (bp)	2162	84/1; 84/1;	513		320000	320000	Rikonfirmim ZVRPP
9	Zef	Mark	Nikolli	2610	38	412		166000	166000	Rikonfirmim ZVRPP
10	Llesh	Gjon	Marku	2933	157/1	159		59000	59000	Rikonfirmim ZVRPP
11	Gjet	Ndue	Kaza	1893	362	539		200000	200000	Rikonfirmim ZVRPP
12	Simon	Kol	Kolaj	3171	3/10	500		293000	293000	Rikonfirmim ZVRPP
13	Pashk	Ndue	Marku	2933	157/4; 158	1948		527000	527000	Rikonfirmim ZVRPP
14	Zek	Gjon	Marpepa	2610	175; 240; 164	950		275000	275000	Rikonfirmim ZVRPP
15	Mark	Ndue	Pjetri	2933	152/12	1650		92000	92000	Rikonfirmim ZVRPP
16	Bardhok	Ndue	Prendi	1221	75/3	462		23000	23000	Rikonfirmim ZVRPP
17	Nikoll	Mark	Gega	2933	176	500		57000	57000	Rikonfirmim ZVRPP
18	Bardhok	Gjergj	Prendi	1221	81/2	861		33000	33000	Rikonfirmim ZVRPP
19	Gjet, Dod Konstandin	Kol	Kolaj Kolaj	3171	3/11	500		146000	146000	Rikonfirmim ZVRPP
20	Mark	Shkurt	Nikolli	2610	40	327		351000	351000	Rikonfirmim ZVRPP
21	Simon	Mark	Nikolli	2610	36	354		250000	250000	Rikonfirmim ZVRPP
22	Nikoll	Ndue	Gjergji (BP)	3259	75/1	6444		1118000	1118000	Rikonfirmim ZVRPP
23	Gjergj	Zef	Ndreca	2162	69/3	147		100000	100000	Rikonfirmim ZVRPP
24	Gjin	Gjegj	Pjetri	3598	26/3	2074		137000	137000	Rikonfirmim ZVRPP
25	Gjet	Nikoll	Persheqefa	1190	58/1	1586		830000	830000	Rikonfirmim ZVRPP
26	Ndue	Preng	Nikolli	3883	17	2922		396000	396000	Rikonfirmim ZVRPP
27	Mark	Gjon	Ndreca	3883	189; 21/4	1404		649000	649000	Rikonfirmim ZVRPP
28	Pashk	Zef	Gjoka	1600	10/5,	1480		400000	400000	Rikonfirmim ZVRPP
29	Gjok Vasil Ilir	Llesh Gjoke Gjoke	Ndreca Ndreca Ndreca	2610	167;165/5; 237	406		138000	138000	Rikonfirmim ZVRPP
30	Fran	Frrok	Doda	2768	345/22; 345/2	1179		156000	156000	Rikonfirmim ZVRPP
31	Fran	Ndue	Biba	2933	152/2; 159	1970	18000	71000	89,000	Rikonfirmim ZVRPP
	SHUMA						18000	8402000	8420000	